

L I G J
Nr. 8560, datë 22.12.1999

PER
PROÇEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË:

V E N D O S I:

K R E U I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Ky ligj përcakton parimet bazë të organizimit dhe të funksionimit të sistemit tatimor në Republikën e Shqipërisë, të procedurave të vendosjes, ndryshimit dhe të heqjes së tatimeve e taksave kombëtare e vendore, të përcaktimit të statusit juridik të tatimpaguesve, të autoriteteve tatimore, të agjentëve tatimorë e të pjesmarrësve të tjerë në marrëdhëniet që rregullohen nga legjislacioni tatimor, të përmbushjes së detyrimeve tatimore dhe të përdorimit të masave shtrënguese për mbledhjen e tatimeve e taksave kombëtare dhe kushtet bazë për mbledhjen e tatimeve e taksave vendore, të mbajtjes së llogarive për tatimet, të përgjegjësisë për shkeljet tatimore dhe për apelimet ndaj veprimeve (ose mosveprimeve) të organeve tatimore dhe punonjësve të tyre.

Neni 2

Sistemi tatimor

Sistemi tatimor i Republikës së Shqipërisë përbëhet nga një paketë ligjesh tatimore, nga marrëveshjet tatimore me vendet e tjera, nga udhëzimet, rregulloret, metodat për vendosjen, ndryshimin dhe heqjen e tatimeve, nga kushtet për të siguruar pagimin e tyre, si dhe format e metodat e kontrollit të tatimeve dhe imponimin e përgjegjësisë për shkeljen e legjislacionit tatimor.

Neni 3

Baza ligjore

Të gjithë personat janë të detyruar të paguajnë tatime e taksa të vendosura me ligj dhe me vendime të pushtetit vendor, të nxjerra në përputhje me të, për aq sa ata janë tatimpagues. Askujt nuk mund t'i kërkohet të paguajë tatime nëse ato nuk janë të vendosura me ligj.

Neni 4

Përkufizimi i tatimit

Tatimi është një pagesë në Buxhetin e Shtetit (më poshtë “buxhet” me natyrë të detyrueshme dhe të pakthyeshme, i cili përfshin edhe dënimet administrative si dhe interesat për pagesë të vonuar të përcaktuara në ligj.

Neni 5

Përkufizimi i taksave

Taksa është një kontribut i kërkuar për t’u paguar nga çdo person i cili drejtpërdrejt përfiton një shërbim publik.

Neni 6

Legjislacioni tatimor në Republikën e Shqipërisë

1. Legjislacioni tatimor në Republikën e Shqipërisë përbëhet nga ligjet për tatimet e taksat nacionale dhe ato vendore dhe kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqerore dhe shendetesore.
2. Në tatimet dhe në taksat nacionale përfshihen:
 - a) Tatimi mbi vlerën e shtuar
 - b) Tatimi mbi të ardhurat
 - c) Akcizat
 - ç) Taksa vendore për biznesin e vogël
 - d) Taksat kombëtare
 - dh)Te ardhurat nga lojrat e fatit
3. Në tatimet dhe taksat vendore përfshihen:
 - a. Tatimi mbi pasurinë;
 - b. Taksat vendore;
4. Të ardhurat nga tatimet dhe taksat nacionale dhe vendore shpërndahen midis buxhetit nacional e atij vendor, në përputhje me ligjin “Për Buxhetin e Shtetit”.
5. Detyrimet tatimore llogariten në formë monetare dhe paguhen në lekë.

Neni 7

Procedurat e vendosjes, të ndryshimit dhe të heqjes së tatimeve

1. Vendosja, ndryshimi apo heqja e një tatimi apo takse kombëtare e vendore bëhet me ligj.
2. Vendosja, ndryshimi apo heqja e një takse vendore bëhet me vendim të pushtetit vendor për atë sa legjislacioni tatimor ua lejon atyre këtë.

Neni 8

Nxjerrja dhe zbatimi i rregulloreve

Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve propozon, dhe Ministri i Financave miraton të gjitha rregulloret e nevojshme në zbatim të ligjeve tatimore. Këto rregullore do të përfshijnë, rregulla që interpretojnë dhe qartësojnë një dispozitë të ligjeve tatimore, do të përshkruajnë procedurat për mbledhjen dhe zbatimin, krijimin e procedurave të njoftimit dhe krijimin e rregullave procedurale.

Neni 9*

Rregullat administrative

1. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve mund të nxjerrë rregulla administrative, që sqarojnë pozicionin zyrtar të administratës tatimore për zbatimin e legjislacionit tatimor.
Çdo njoftim i përgjithshëm administrativ është i detyrueshëm për administratën tatimore dhe për tatimpaguesit, me përjashtim të rastit kur gjykata provon se ai bie në kundërshtim me ligjin.
2. Njoftimet e përgjithshme administrative, që prekin të gjithë tatimpaguesit, janë të detyrueshme për t'u zbatuar vetëm pasi ato të jenë publikuar. Mënyra dhe organi i publikimit përcaktohet në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të ligjit.

Neni 10

Marrëveshjet ndërkombëtare

1. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve mund të hyjë në tratativa për marrëveshje ndërkombëtare për eliminimin e tatimeve të dyfishta, dhe nënshkrimi e miratimi i tyre bëhet sipas Ligjit "Për lidhjen e marrëveshjeve dhe traktateve ndërkombëtare".
2. Për çdo projektligj apo marrëveshje ndërkombëtare që përmban dispozita tatimore, para miratimit të tyre nga Këshilli i Ministrave, merret mendimi zyrtar i Ministrit të Financave.

Neni 11

Përkufizime të tjera

Për qëllime të këtij ligji, përcaktimet e mëposhtme kanë kuptimin si vijon :

- a. Termi "person" përdoret për çdo "person fizik jotregtar" të përcaktuar sipas Kodit Civil, për çdo "person fizik tregtar" dhe për çdo "person juridik" të themeluar sipas ligjit "Për shoqëritë tregtare", sipas Kodit Civil apo sipas çdo ligji tjetër të veçantë.
- b. "Tatimpaguesi" është një person i cili është subjekt i tatimeve dhe/ose taksave.
- c. "Periudha tatimore" fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti kalendarik.
- ç. "Vendimi i veçantë ekzekutiv" është një urdhër bllokimi apo një urdhër sekuestrimi, që lëshohet nga organet tatimore. Ai është titull ekzekutiv dhe në rast se nuk paguhet vullnetarisht, ekzekutohet forcërisht nga organet tatimore.

Neni 12

Përfaqësuesi i tatimpaguesit

1. Përfaqësuesi i tatimpaguesit është një person që një tatimpagues zgjedh për ta përfaqësuar në lidhje me çështjet tatimore. Zgjedhja bëhet sipas dispozitave të Kodit Civil.
2. Përfaqësuesit e tatimpaguesit të zgjedhur në mënyrë të rregullt marrin përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet e tatimpaguesit, me përjashtim të rasteve kur me ligj

parashikohet ndryshe. Tatimpaguesit që jetojnë jashtë Republikës së Shqipërisë duhet të caktojnë një përfaqësues tatimor në Shqipëri.

3. Fakti që një përfaqësues bën një gabim në deklarimin dhe pagesën e tatimeve, nuk e shkarkon tatimpaguesin nga përgjegjësia për gabimin.

Neni 13

Agjentët tatimorë

1. Agjenti tatimor është një person, jo i punësuar në organet tatimore, i cili sipas këtij Ligji apo çdo ligji tjetër të sistemit tatimor është përgjegjës për llogaritjen, mbajtjen në burim për një tatimpagues dhe kalimin e tatimeve dhe taksave në buxhet.

2. Në përputhje me të drejtat dhe detyrimet e tij, agjenti tatimor ka të njëjtin status me tatimpaguesin nëqoftëse me ligj nuk përcaktohet ndryshe.

3. Agjenti tatimor është i detyruar:

a. Të llogarisë, të mbajë në burim për tatimpaguesin dhe të transferojë në buxhet, në mënyrë korrekte dhe në kohën e duhur shumat e tatimeve e taksave;

b. Të mbajë regjistrime për të ardhurat e paguara tatimpaguesve dhe për tatimet e mbajtura dhe të transferuara në buxhet duke përfshirë mbajtjen e regjistrimeve të veçanta për çdo tatimpagues;

c. T'u japë organeve tatimore dokumentacionin e kërkuar për kontrollin e saktësisë së llogaritjeve, të mbajtjes në burim dhe të pagimit të tatimeve e taksave;

d. Të përmbushë të gjithë detyrimet e tjera të përcaktuara nga ligjet tatimore.

4. Për mospërmbushje apo përmbushje me mangësi të detyrimeve të tyre të përcaktuara në ligjet tatimore, agjentët tatimore mbajnë përgjegjësi në përputhje me procedurat e vendosura nga ky ligj dhe aktet e tjera ligjore.

Neni 14

Përgjegjësia tatimore

1. Përgjegjësia tatimore e një personi fillon kur personi është i përfshirë në aktivitete ose fiton pasuri të cilat kanë elementë të tatueshëm sipas dispozitave të legjislacionit tatimor.

2. Përgjegjësia tatimore mbaron kur një person nuk është i përfshirë më në aktivitete ose nuk zotëron më pasuri të cilat kanë elementë të tatueshëm dhe i ka paguar të gjitha tatimet, taksat, gjokat dhe interesat për të cilat detyrohet.

K R E U II

ADMINISTRATA TATIMORE

Neni 15

Struktura e administratës tatimore

Administrata tatimore administron tatimet e taksat në Shqipëri. Administrata tatimore përbëhet nga:

a. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;

b. Degët e tatimeve në rrethe;

c. Komisioni i Apelimit të Tatimeve;

d. Zyrat tatimore të pushtetit vendor.

Neni 16

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

1. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është autoriteti qendror i vetëm tatimor në Republikën e Shqipërisë. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Degët e saj në rrethe janë organet kompetente që zbatojnë dhe administrojnë tatimet. Ajo e ka selinë në Tiranë.
2. Drejtori i Përgjithshëm drejton Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, si dhe organet tatimore në rrethe. Ai emërohet dhe shkarkohet nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Financave dhe përgjigjet para Qeverisë dhe Ministrit të Financave.
3. shfuqizohet.

Neni 17*

Detyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve kryen detyrat e mëposhtme :

- a) Organizon dhe drejton veprimtarinë e të gjithë administratës tatimore qendrore, për të siguruar mbledhjen e detyrimeve tatimore.
- b) (Shfuqizohet)
- c) Siguron një zbatim uniform të ligjeve dhe të rregulloreve që kanë të bëjnë me tatimet.
- ç) Përgatit udhëzime, metodika, shpjegime dhe opinione për edukimin e tatimpaguesve për zbatimin e legjislacionit tatimor.
- d) Përgatit projektprogramin e të ardhurave tatimore për vitin pasardhës.
- dh) Mbledh sistematikisht të dhëna, mbikqyr tatimet dhe taksat kombëtare dhe ato vendore si dhe përgatit raporte e analiza që kanë të bëjnë me mbledhjen e të ardhurave tatimore.
- e) Zgjidh konfliktet ndërmjet degëve.
- ë) Siguron bashkëpunimin e institucioneve të specializuara të kontabilitetit për sa ato janë të lidhura me zbatimin e sistemit tatimor.
- f) Organizon dhe vë në jetë edukimin profesional dhe trainimin e personelit të organeve tatimore.
- g) Siguron etikën profesionale brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe degëve të saj. Siguron zbatimin e kodit të etikës të punonjësve të shërbimit civil për punonjësit e administratës tatimore.
- gj) Kryen të gjitha detyrat e tjera të nevojshme për administrimin e drejtë të sistemit tatimor, që nuk shkelin të drejtat e tatimpaguesve, të përcaktuara me ligj.

Neni 17/1*

Policia Tatimore

1. Në strukturën e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe të degëve të saj funksionon Policia Tatimore. Detyrat e Policisë Tatimore në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe në degët e saj, përcaktohen në nenin 17/2 të këtij ligji dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të tij.
2. Policia Tatimore ka në përbërje:
 - a. Drejtorinë e Policisë Tatimore e cila është pjesë përbërëse e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

- b. Sektorët apo zyrat e Policisë Tatimore të cilat janë pjesë e degëve të tatimeve. Numri i punonjësve të sektorëve apo zyrave të Policisë Tatimore dhe organizimi i tyre propozohet nga kryetari i degës së tatimeve dhe miratohet nga Drejtori i Përgjithshëm.
3. Drejtoria e Policisë Tatimore varet nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve dhe raporton para tij. Sektorët apo zyrat e Policisë Tatimore varen nga kryetarët e degëve të tatimeve dhe raportojnë para tyre.
4. Drejtori i Policisë Tatimore është përgjegjës për drejtimin e Drejtorisë së Policisë Tatimore, ndërsa përgjegjësat e sektorëve apo zyrave janë përgjegjës për drejtimin e sektorëve apo zyrave të policisë tatimore në degët e tatimeve. Personeli i Policisë Tatimore është i ndare në oficerë dhe nënoficerë.
5. Punonjësit e Policisë Tatimore, gjatë kryerjes së detyrës, mbajnë uniformë dhe armë. Kur për qëllime operacionale, lind nevoja që punonjësit e policisë tatimore të veprojnë pa uniformë, ata janë të detyruar të paraqesin dokumentin e identifikimit, të lëshuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve. Ministria e Rendit Publik, sipas kërkesës me shkrim të Drejtorit të Përgjithshëm të tatimeve pajis me armatim punonjësit e Policisë Tatimore. Armatimi përdoret në përputhje me dispozitat ligjore për armët. Mjetet e Policisë Tatimore janë me mbishkrimin “Policia Tatimore” dhe në to përdoren sinjalet pamore dhe zanore të përcaktuara në Kodin Rrugor.
6. Punonjësit e Policisë Tatimore janë të detyruar të zbatojnë Kodin e Etikës si dhe dispozitat e Kodit të Etikës së Policisë së Shtetit, të përcaktuara në Ligjin Nr.8291, datë 25.02.1998 “Kodi i Etikës së Policisë”.

Neni 17/2***

Detyrat e Policisë Tatimore

Policia Tatimore kryen këto detyra:

1. Verifikon regjistrimin dhe pajisjen me çertifikatë tatimore të të gjithë personave që kryejnë veprimtari ekonomike.
2. Zbaton masat shtrënguese për mbledhjen e tatimeve sipas urdhërit ekzekutiv të lëshuar nga kryetari i degës së tatimeve.
3. Zbaton sanksionet e ndërmarra nga dega e tatimeve sipas urdhërit ekzekutiv të lëshuar nga kryetari i degës së tatimeve.
4. Verifikon dokumentimin e lëvizjes së mallrave dhe të udhëtareve në të gjitha llojet e transportit.
5. Verifikon zbatimin nga tatimpaguesit e regjistruar në TVSH, të detyrimit për të lëshuar dokumentin e duhur për shitje malli ose shërbimi.
6. Verifikon zbatimin e Ligjit «Për taksën vendore mbi biznesin e vogël» dhe të Kreut III «Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin» të Ligjit «Për Tatimin mbi të Ardhurat» lidhur me detyrimin e tatimpaguesve për :
 - a) Lëshimin e kuponit, dëftesës dhe faturës tatimore.
 - b) Mbajtjen e librave të xhiros dhe të blerjeve.

- c) Afishimin e çmimeve përfundimtare të shitjes.
 - d) Dokumentimin e mallrave gjendje.
7. Verifikon përdorimin e pullave të akcizës dhe zbatimin e kërkesave të tjera për mallrat që i nënshtrohen akcizës, dhe merr masa për zbatimin e sanksioneve të vendosura për shkeljen e Ligjit “Për Akcizat”.
- ***
- 7/1. Verifikon në vend numrin e punonjësve të punësuar te punëdhënësi dhe vendos penalitetet e përcaktuara në nenin 52/3 të ligjit për çdo punonjës të padeklaruar në administratën tatimore.
8. Ndhmon veprimtarinë e inspektorëve të tjerë të administratës tatimore, kur këto të fundit e kërkojnë një gjë të tillë, gjatë zhvillimit të kontroleve tatimore për të gjitha llojet e tatimeve të drejtëpërdrejta ose të tërthorta pranë tatimpaguesve, duke vepruar në këtë rast si forcë mbështetëse.
9. Për zbatimin e pikave 1, 4, 5, 6 dhe 7 të këtij neni, punonjësit e Policisë Tatimore kanë të drejtë të vendosin në vend sanksionet e përcaktuara në këtë ligj apo në ligjet e veçanta tatimore.
10. Mbledh dhe raporton të dhëna që kanë të bëjnë me shmangien tatimore të tatimpaguesve.”

Neni 18

Degët e tatimeve

Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve ka degët e veta në rrethe. Kryetari i Degës drejton degën e tatimeve. Ai emërohet dhe shkarkohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve. Degët e tatimeve pajisin tatimpaguesit me çertifikatë tatimore, hartojnë projektprogramin e të ardhurave tatimore për rrethin, ndjekin dhe përgjigjen për realizimin e programit të të ardhurave tatimore, përpunojnë deklaratat tatimore, përcaktojnë dhe nxjerrin detyrimin tatimor, bëjnë ruajtjen dhe organizimin e dokumentacionit, kryejnë kontrollin e tatimpaguesve dhe mbledhjen e tatimeve, si dhe zbatojnë vendimet e veçanta ekzekutive.

Neni 19***

Buxheti i administratës tatimore

Fondet për administrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe degëve të saj në rrethe sigurohen nga Buxheti i Shtetit. Përfundimisht për vitin 2006, pjesa e të ardhurave, që do të përdoret për investime e shpenzime operative, është sipas ligjit nr. 9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”.

Neni 20*

Organika dhe pagat

1. Kryeministri me propozimin e Ministrit të Financave, miraton numrin e përgjithshëm të punonjësve të administratës tatimore, strukturën e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe strukturën tip të degëve të tatimeve. Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve merr masat për rekrutimin e personelit në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe në degët e saj, në përputhje me Ligjin nr. 8549, datë

11.11.1999 “Statusi i nënpunësit civil”. Për nënpunësit drejtues dhe specialistë egzistues të administratës tatimore, periudha e provës për të fituar statusin e nënpunësit civil përfundon më 31 dhjetor 2005 dhe për ato të punësuar pas datës 31 dhjetor 2004, periudha e provës do të jetë në përputhje me ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nënpunësit civil”.

2. Në organikë, personeli ndahet sipas detyrave, në punonjës të nivelit të lartë, të mesëm e të ulët drejtues dhe në punonjës ekzekutues të kategorizuar në aktet nënligjore, në zbatim të këtij ligji.

3. Detyrat dhe funksionet e secilës prej kategorive të mësipërme, si dhe procedurat dhe afatet e kalimit nga një nivel me i ulët në një nivel më të lartë karriere përcaktohen në aktet nënligjore në zbatim të këtij Ligji. Kalimi në një nivel karrierë më të lartë nuk mund të bëhet pa kaluar nivelin pararendës me të ulët të karrierës. Përrjashtim bëhet vetëm për postin e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.

3. Këshilli i Ministrave përcakton nivelin e pagës për cdo kategori të personelit, të parashikuar në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 20/1*

Emërimi i personelit

1. Për nënpunësit drejtues dhe specialistë të administratës tatimore zbatohet legjislacioni i nënpunësit civil për institucionet e pavarura, përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.

2. Departamenti i Administratës Publike ushtron në administratën tatimore kompetencat e parashikuara në nenin 4 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nënpunësit civil”, me përjashtim të atyre të parashikuara në pikat VI e VII të shkronjës “b” të pikës 4 të këtij neni.

3*. Marrëdhëniet juridike të punës për punonjësit e Policisë Tatimore dhe për personelin ndihmës të administratës tatimore, rregullohen me kontratë sipas dispozitave të Kodit të Punës.”

Neni 20/2

Shpërblimet e personelit

1. Personelit të administratës tatimore, në përputhje me dispozitat e tjera ligjore e nënligjore në fuqi për nënpunësit publike, i njihen shpërblime stimuluese, sipas kriterëve të mëposhtëme:

- a. shërbimi i kryer në organet tatimore;
- b. shërbime me rrezik të veçantë për personin;
- c. efikasiteti në punë.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, për rastet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni dhe me udhëzim të Ministrit të Financave, në zbatim të këtij ligji, bën përcaktimin e këtij shpërblimi ndërmjet personelit të administratës tatimore.

Neni 20/3* **Shfuqizohet**

Neni 20/4

Komisioni i disiplinës se tatimeve

Në përberje të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve ngrihet Komisioni i Disiplinës së Tatimeve, i përbërë nga 7 anëtare. Përbërja, përgjegjësitë dhe mënyra e funksionimit të tij përcaktohen me rregullore të veçantë të Ministrit të Financave.

Neni 21

Komisioni i Apelimit të Tatimeve

Komisioni i Apelimit të Tatimeve përbëhet nga 7 anëtarë të cilët emërohen nga Ministri i Financave. Nga këta, dy anëtare përzgjidhen nga Ministri i Financave, dy anëtarë përzgjidhen mbi bazën e propozimeve të Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë në konsultim me shoqatat e biznesit, një anëtar mbi bazën e propozimeve të shoqatave të ekonomistëve, një anëtar mbi bazën e propozimit të Ministrit të Drejtësisë dhe një anëtar mbi bazën e propozimit të Ministrit të Ekonomisë. Anëtarët e Komisionit të Apelimit të Tatimeve të jenë të profesionit ekonomist e jurist. Komisioni i Apelimit të Tatimeve është organ i pavarur pranë Ministrit të Financave dhe i pavarur në vendimmarrje. Ai ka në përbërje të tij edhe një sekretar. Mandati i anëtarëve të Komisionit të Apelimit të Tatimeve është jo më pak se dy vjet, me të drejtë ripropozimi dhe rimerimi. Mënyra e funksionimit të Komisionit të Apelimit të Tatimeve, procedurat e tij operative, procedurat e shkarkimit të anëtarëve dhe mënyra e shperblimit të tyre përcaktohen me rregullore të nxjerrë nga Ministri i Financave. Komisioni i Apelimit të Tatimeve ka gjithë autoritetin e nevojshëm për të shqyrtuar apelimin e tatimeve, duke përfshirë të drejtën për të kryer hetime dhe rillogaritje të detyrimeve tatimore të përcaktuara.

Neni 22

Zyrat tatimore të pushtetit vendor

Tatimet dhe taksat vendore administrohen nga organet e qeverisjes vendore, të cilat kanë në vartësi zyrat tatimore të pushtetit vendor.

Dispozitat e këtij ligji vlejnë edhe për administrimin e tatimeve e taksave vendore, brenda kompetencës së organeve të qeverisjes vendore.

Neni 23

Marrëdhëniet me organet e tjera shtetërore

1. Administrata tatimore kryen detyrat e saj në mënyrë të pavarur nga organet e tjera shtetërore qendrore apo vendore. Ajo nuk shërben si agjent për organet dhe institucionet e tjera shtetërore dhe nuk ka përgjegjësi për të mbledhur detyrimet dhe gjobat për organet dhe institucionet e tjera shtetërore, përveç rasteve kur me ligj përcaktohet ndryshe.

2. Organet e tjera shtetërore janë të detyruara të japin informacione për administratën tatimore sipas kërkesës së saj për të ndihmuar në zbatimin e legjislacionit tatimor dhe në vendosjen e kontrollit mbi pagimin e tatimeve. Këto organe e kanë të ndaluar të ndërhyjnë në funksionet e administratës tatimore.

Neni 24

Marrëveshjet me autoritetet e huaja tatimore

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ngarkohet për negocimin dhe administrimin e të gjitha marrëveshjeve ndërkombëtare që kanë lidhje me tatimet. Në rastet e

mosmarrëveshjeve me autoritetet e huaja tatimore, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është përfaqësuesi zyrtar i Republikës së Shqipërisë, e ngarkuar me detyrën për t'i zgjidhur këto mosmarrëveshje.

Neni 25

Shmangia e konfliktit të interesave

Punonjësit e administratës tatimore janë të ndaluar të kontrollojnë dhe të llogarisin tatimet e të afërmëve të tyre. Punonjësit e administratës tatimore nuk mund të përfshihen në kontrole në rastet kur ekziston një marrdhënie e drejtpërdrejtë apo tërthore, konflikt interesi ose mosmarrëveshje vetjake ndërmjet tyre dhe tatimpaguesit.

Punonjësit e administratës tatimore nuk lejohen të drejtojnë aktivitete private si dhe të jenë të punësuar në sektorin privat.

Neni 26

Masat disiplinore

1. Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve është përgjegjës për dhënien e masave disiplinore ndaj punonjësve të organeve tatimore kur veprimet e këtyre të fundit nuk përbëjnë vepër penale, por janë në kundërshtim me dispozitat e ligjeve tatimore dhe akteve nënligjore. Masat disiplinore merren sipas dispozitave të Kodit të Punës, të ligjit “Për Statusin e nënpunësit civil në Republikën e Shqipërisë” dhe të akteve nënligjore në zbatim të tyre.

2. Kur punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve ose degëve të tatimeve, konstatohet se kanë kryer një vepër penale, sipas një raporti apo akt kontrolli me shkrim nga i ngarkuari për verifikim, në këtë rast Drejtori i Përgjithshëm e kalon çështjen në prokurori për ndjekje penale.

3. Punonjësit e administratës tatimore të cilët abuzojnë me autoritetin e tyre janë përgjegjës për dëmet që i shkaktojnë tatimpaguesve.

4. Moszbatimi i kërkesave të këtij ligji dhe i ligjeve të tjera tatimore nga punonjësit e administratës tatimore ndëshkohet sipas dispozitave ligjore në fuqi, në bazë të ankesave të paraqitura në Komisionin e Disiplinës së Tatimeve. Ky komision, pasi shqyrton ankesën e paraqitur, përcakton shkëljen e kryer nga punonjësi dhe shkallën e përgjegjësisë dhe i propozon Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve masën përkatëse disiplinore për punonjësin e administratës tatimore.

Neni 27

Mbajtja e regjistrimeve

Administrata tatimore regjistron në mënyrë sistematike dhe kronologjike të dhënat e nevojshme për llogaritjen e saktë të detyrimit tatimor. Për këtë arsye, ajo regjistron të gjithë informacionin përkatës të kërkuar nga aktet ligjore e nënligjore në fuqi, i cili i dorëzohet administratës tatimore drejtpërdrejtë ose tërthorazi.

Neni 28

Sistemi qendror i të dhënave

Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve krijon sistemin qendror të të dhënave, i cili përmban të dhënat bazë identifikuese për secilin tatimpagues.

Neni 29

Informimi publik

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka për detyrë t'i shpjegojë publikut përmbajtjen, rolin dhe rëndësinë e ligjeve fiskale, duke përdorur radion, televizionin dhe gazetën. Gjithashtu ajo mund të botojë sqarues, komentarë dhe libra të ndryshëm shpjegues për sistemin tatimor.

Venia në dijeni publikisht e tatimpaguesve dhe e publikut, për ligjet e reja tatimore dhe/ose ndryshimet e bëra për legjislacionin tatimor egzistues dhe për aktet nënligjore në zbatim të tyre, kryhet nëpërmjet medias, faqes së internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, shtypit periodik dhe fletpalosjeve, jo më vonë se 15 dite nga data e miratimit të tyre.

K R E U III

PROÇEDURAT E ADMINISTRIMIT TE TATIMEVE

Neni 30***

Pajisja me çertifikatë tatimore

1. Çdo person e fiton të drejtën të ushtrijë veprimtari ekonomike vetëm pasi të regjistrohet në gjykatë. Pas këtij regjistrimi, ai detyrohet të kërkojë pajisjen me çertifikatë tatimore. Kjo kërkesë paraqitet në Degën e Tatimeve të rrethit ku personi ka selinë e veprimtarisë së tij. Mosparaqitja e kërkesës për çertifikatë tatimore nuk e përjashton personin nga përgjegjësia tatimore.

Ortakëritë që kryejnë një veprimtari të përkohshme, të përbashkët, me qëllim fitimi dhe që nuk krijohen si persona juridike më vete, në format e parashikuara nga ligji 7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", i ndryshuar, i nënshtrohen detyrimit për t'u regjistruar në organet tatimore.

*****Personat e tatuashëm kanë selinë qendrore në vendin e menaxhimit efektiv të biznesit. Kriteret për përcaktimin e vendit efektiv të biznesit përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, në zbatim të këtij ligji.**

***** 2. Për tu pajisur me Çertifikatë Tatimore duhet të paraqesë vendimin e gjykatës dhe të plotësojë formularin "Kërkesë për regjistrim". Administrata tatimore përpunon kërkesën për çertifikatë tatimore brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës. Tatimpaguesi regjistrohet vetëm një herë, në çastin e fillimit të veprimtarisë ekonomike.**

Nëse tatimpaguesi nuk pajiset me çertifikatë tatimore brenda pesë ditëve pune, ai quhet i regjistruar.

***** 3. Shfuqizohet**

4. Për tatimpaguesit e identifikuar nga punonjësit e administratës tatimore, qendrore dhe vendore, që punojnë pa u regjistruar mbahet një regjister shtesë, që shoqëron regjistrin sipas pikës 4 të këtij neni.

Neni 30/1

Regjistrimi i organizatave jo fitimpruese

1. Detyrimit për t'u regjistruar në organet tatimore dhe për t'u pajisur me çertifikatë tatimore u nënshtrohen edhe organizatat jofitimpruese, fondacionet, njësitë e

zbatimit të projekteve, etj, që ushtrojnë veprimtari të karakterit fetar, humanitar, bamirës, shkencor ose edukativ, pavarësisht nga fakti se veprimtaria e tyre mund të mos jetë ekonomike e fitimprurese. Për t'u pajisur me certifikatë tatimore, personat fizike ose juridikë të mësipërm duhet të paraqesin në organet tatimore, përveç vendimit të gjykatës për regjistrimin e tyre, statutin dhe të dhëna të tjera kontakti. Organet tatimore mbajnë një regjister të veçantë për evidentimin e këtyre personave, duke i vlerësuar ata, për efekte fiskale, si tatimpagues pasive.

2. Personat fizikë ose juridikë që detyrohen të regjistrohen në organet tatimore, sipas pikës 1 të këtij neni, të cilët, krahas veprimtarisë me karakter fetar, humanitar, bamirës, shkencor ose edukativ, kryejnë edhe veprimtari të tjera, me karakter ekonomik, janë të detyruar të regjistrojnë veçmas këto aktivitete në organet tatimore, njëllëj si çdo tatimpagues tjetër, që ushtron veprimtari ekonomike, në përputhje me nenin 30 të këtij ligji.

Neni 31

Tërheqja e certifikatës tatimore

Tërheqja e certifikatës tatimore bëhet vetëm sipas dispozitave të këtij ligji. Një person i cili vazhdon veprimtarinë pas tërheqjes së certifikatës tatimore, është subjekt i masave ndëshkuese në bazë të dispozitave të këtij ligji. Kur kushtet që sollën tërheqjen kanë ndryshuar, tatimpaguesi mund të kërkojë të pajiset përsëri me certifikatë tatimore.

Neni 32*

Çregjistrimi i tatimpaguesit

1. Tatimpaguesit kanë të drejtë të kërkojnë të çregjistrohen me vendim gjykate, vetëm pasi të kenë paguar të gjithë detyrimet tatimore të papaguara dhe pasi të kenë paraqitur bilancin e mbylljes.

- a. Gjykata njofton organin tatimor për kerkesën për çregjistrim të tatimpaguesit. Organi tatimor, brenda 45 ditësh nga data e njoftimit është i detyruar të verifikojë situatën tatimore dhe, kur është e nevojshme të ushtrojë kontrollin në vënd të veprimtarisë së tatimpaguesit që kërkon të çregjistrohet të paraqitur në bilancin e mbylljes.
- b. Kur organi tatimor brenda 45 ditëve nga data e njoftimit të marrë paraqet kundërshtimin e tij, gjykata nuk mund të vendosë për çregjistrimin e tatimpaguesit. Organi tatimor është i detyruar të tërheqë kundërshtimin vetëm pasi tatimpaguesi të ketë paguar të gjithë detyrimet e papaguara të cilat i janë njoftuar me shkrim tatimpaguesit deri në datën e njoftimit për çregjistrim.
- c. Nëse pas 45 ditësh nga data e njoftimit, organi tatimor nuk ka paraqitur ndonjë kundërshtim me shkrim, gjykata vendos për çregjistrimin e tatimpaguesit.

2. Në rast kundërshtimi nga organi tatimor, gjykata nuk i kryen veprimet për çregjistrimin. Kundërshtimi tërhiqet vetëm pasi janë paguar tatimet ose janë dhënë

garancitë. Nëse organi tatimor nuk pranon të tërheqë kundërshtimin, gjykata duhet ta gjykojë çështjen brenda 30 ditëve nga njoftimi i këtij kundërshtimi.

3. Organet tatimore kanë të drejtë të çregjistrojnë nga regjistri aktiv i tatimpaguesve çdo tatimpagues, kur provohet se ai për çfarëdo arsye në vitin e fundit fiskal nuk ka ushtruar veprimtari. Në këtë rast, këta tatimpagues mbahen pasive në një regjistër të veçantë të organeve tatimore.

4. Çregjistrimi, në çdo rast nuk eliminon detyrimin tatimor ekzistues.

Neni 33

Vlerësimi tatimor

1. Vlerësimi tatimor është llogaritja që i bën administrata tatimore shumës së detyrimit tatimor si dhe dënimeve administrative e interesave për pagesë të vonuar që detyrohet të paguajë një tatimpagues. Vlerësimi tatimor është detyrim ndaj shtetit, i pagueshëm në buxhet i cili i njoftohet tatimpaguesit me shkrim në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose me shërbim postar.

2. Administrata tatimore është e autorizuar të bëjë vlerësim tatimor për çdo detyrim të tatimpaguesve sipas ligjeve tatimore në fuqi mbi bazën e informacioneve të mëposhtëme:

a. informacionet që përmbajne deklaratat tatimore të tatimpaguesve; dhe

b. materialet e kontrollit dhe çdo informacion tjetër i njohur nga administrata tatimore sipas nenit 36 të këtij ligji.

Nëqoftesë një tatimpagues nuk jep informacionin e nevojshëm për një vlerësim tatimor, administrata tatimore ka të drejtën të vlerësojë tatimin mbi bazën e çdo informacioni të vlefshëm të përcaktuar në akte nënligjore.

3. Në rastet kur ligjet tatimore nuk kërkojnë pagimin e detyrimeve nëpërmjet deklaramit dhe në rastet kur administrata tatimore bazuar në fakte çmon se vlerësimi tatimor i bërë më parë nuk ka qënë i saktë, ajo mund të bëjë një vlerësim të ri, ku të argumentojë shkaqet e rivlerësimit me përlogaritjet përkatëse dhe ta dërgojë njoftim vlerësimit tek tatimpaguesi sipas pikës 1 të këtij neni. Në rastin e rivlerësimit në rritje të detyrimit tatimor, tatimpaguesit i lihet nje afat sa dyfishi i afatit normal për pagimin e shtesës së detyrimit. Ne rastin e rivlerësimit ne rritje te detyrimit tatimor, qe nuk buron nga nje aktkontroll, tatimpaguesit i lihet nje afat sa dyfishi i afatit normal per pagimin e shteses se detyrimit, si dhe per apelimin e tij ne instancat e parashikuara nga ky ligj.

4. Në rastin kur për një tatim kërkohet deklaratë tatimore, deklarata përcakton detyrimin tatimor të tatimpaguesit dhe ajo konsiderohet të jetë:

a) Vlerësim tatimor për një tatim; dhe

b) njoftim dhe kërkesë për të paguar një tatim në afatin e përcaktuar në ligj.

5. Për tatimet e mbajtura në burim, kur një tatimpagues nuk paraqet një deklaratë tatimore, administrata tatimore nuk bën në këtë rast një vlerësim tatimor për detyrimin e tatimpaguesit mbi bazën e informacioneve të tjera. Administrata tatimore në këtë rast e konsideron të bërë vlerësimin tatimor të detyrimit të tatimpaguesit.

6. Kryetari i degës së tatimeve ka të drejtë të nxjerrë një urdhër të veçantë ekzekutiv para datës në të cilën tatimi duhet të paguhet, nëqoftëse ky veprim kërkohet të kryhet për të siguruar mbledhjen e detyrimeve si në rastin e veçante kur tatimpaguesi mendohet se tenton të bëjë evazion nëpërmjet largimit, transferimit të aseteve tek një person tjetër ose duke ndërmarrë veprime të tjera të cilat rrezikojnë mbledhjen e detyrimeve sidomos kur për të është bërë një vlerësim tatimor.

Vlerësimi tatimor i bërë në këtë mënyrë mund të kundërshtohet nga tatimpaguesi përfshirë këtu edhe ankimimin në organet gjyqësore.

Neni 34

Njoftimi i vlerësimit tatimor dhe kërkesave për pagimin e detyrimeve

Tatimpaguesit i jepet njoftim vlerësimi për një detyrim tatimor. Njoftimi për vlerësimin tatimor duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

- a) Emrin dhe mbiemrin e tatimpaguesit, si dhe emrin tregtar të tij.
- b) Numrin e identifikimit dhe kodin fiskal të tatimpaguesit.
- c) Datën e njoftim vlerësimit.
- ç) Qëllimin e lëshimit të njoftim vlerësimit, periudhën apo periudhave që ai u referohet.
- d) Shumën e detyrimit të vlerësuar, dënimet dhe interesat eventuale për pagesë të vonuar.
- dh) Kërkesën për pagimin e tatimit dhe afatin e pagesës.
- e) Vendin dhe mënyrën e pagesës së detyrimit.
- ë) Një përshkrim të arsyeve të bërjes së vlerësimit tatimor.
- f) Proçedurat e apelimit.

Neni 35

Parashkrimi i së drejtës për përcaktimin e detyrimit tatimor

1. E drejta e organeve tatimore për të kontrolluar dhe për të korigjuar vlerësimin e një detyrimi tatimor, parashkruhet 5 vjet pas lindjes së detyrimit (koha që tatimi duhej të ishte deklaruar ose paguar, cilido qofte çasti më i fundit në kohë) Afati i parashkrimit ndërpritet në rastet e mëposhtme:

- a) Gjatë apelimit të këtij detyrimi.
- b) Gjatë kohëzgjatjes së garancisë për një pagesë tatimore.
- c) Gjatë periudhës në të cilën tatimpaguesi për këtë detyrim është nën një hetim zyrtar në vazhdim, deri në dhënien e një vendimi përfundimtar.
- Ç) Gjatë periudhës në të cilën tatimpaguesi është i përfshirë në një çështje penale që ka lidhje me këtë detyrim tatimor.

2. Pas çdo ndërprerjeje, afati rifillon që nga çasti i ndërprerjes. Në çdo rast, e drejta për të kontrolluar dhe për të korigjuar një vlerësim të një detyrimi tatimor, parashkruhet 15 vjet pas lindjes së detyrimit tatimor.

3. Çështjet penale rregullohen sipas afateve të parashkrimit të parashikuara nga Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.

Neni 36 ***

Metoda alternative të përcaktimit të detyrimit tatimor

Organet tatimore mund të rikarakterizojnë transaksionet për të reflektuar situatën ekonomike reale dhe ato mund të mos marrin parasysh formën e transaksionit për të përcaktuar me saktësi përmbajtjen e tij. Rikarakterizimi i transaksioneve bëhet:

- a) Kur tatimpaguesi, për një periudhë të caktuar tatimore, nuk ka deklaruar detyrimet e tij tatimore, siç përcaktohet në ligjet e veçanta tatimore.
- b) Kur gjatë kontrollit të kryer nga organet tatimore nuk gjëndet dokumentacioni i duhur për përcaktimin e detyrimit tatimor, ose kur ky dokumentacion ka mangësi

serioze, të cilat nuk lejojnë paraqitjen e situatës reale të tatimpaguesve dhe llogaritjen e detyrimeve të tyre tatimore.

c) Kur tatimpaguesit deformojnë çmimet e shitjes. Me deformim të çmimeve të shitjes do të kuptohet çdo rast kur çmimet e shitjes të mallrave e shërbimeve të dokumentuara për efekt të detyrimeve fiskale janë të ndryshëm nga çmimet reale faktike të shitjes nga tatimpaguesi, sipas fakteve të ofruara nga organi tatimor, ose janë dukshëm më të ulta për një kohë të konsiderueshme nga çmimet krahasuese në treg të të njëjtit mall.

Rikarakterizimi i transaksioneve për të reflektuar gjendjen reale të të ardhurave nga shitja të një tatimpaguesi, duke marrë për bazë çmimet reale të tregut, bëhet vetëm me urdhër me shkrim të kryetarit të degës së tatimeve, sipas propozimit me shkrim argumentuar, me fakte dhe prova, të inspektorit të kontrollit, për mundësinë e deformimit të çmimeve të shitjes nga tatimpaguesi.

ç. Kur tatimpaguesi kryen me lekë në dorë transaksione shitblerjeje që kalojnë shumë 500 mijë lekë për vitin 2004 dhe 300 mijë lekë për vitet në vijim.

Rikarakterizimi i transaksioneve për të reflektuar gjendjen reale ekonomike të një tatimpaguesi mund të bëhet vetëm me urdhër të kryetarit të degës së tatimeve, në bazë të propozimit me shkrim të inspektorëve të grupit të kontrollit. Përcaktimi i detyrimeve tatimore në rastet e mësipërme bëhet sipas udhëzimit në zbatim të këtij ligji, i cili perfshin përdorimin e koeficientëve teknikë, vlerësimin dhe zhvlerësimin e pasurisë, standartet industriale, numrin e punonjësve, llojin e klientëve, çmimet krahasuese dhe qarkullimin e mallrave të tatimpaguesve të ngjashëm. Përcaktimi i këtyre treguesve bëhet në mbështetje të legjislacionit në fuqi, si dhe në baze të dhenave të shoqatave të specializuara të biznesit.

Në çdo rast rikarakterizimi i transaksioneve bëhet në mbështetje të ligjeve në fuqi, si dhe në informacionet e ofruara nga Instituti i Statistikave ose shoqatat e specializuara të biznesit dhe i njoftohen në kohe paraprakisht tatimpaguesit.

*** Për zbatimin e shkronjave “a”, “b”, “c” dhe “ç” të këtij neni, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve këshillohet me shoqatat e specializuara të biznesit, për të përcaktuar vlerën orientuese të tatueshme, në bazë të së cilës bëhet përcaktimi i detyrimeve tatimore. Vlera orientuese e tatueshme përcaktohet me akte nënligjore.

Neni 36/1 *

Arkëtimet dhe pagesat

Për çdo transaksion shitblerjeje që e kalon vlerën 300 mijë lekë, tatimpaguesit, që shesin dhe ata që blejnë, nuk mund të bëjnë arkëtime ose pagesa në lekë në dorë (cash). Në këtë rast ata janë të detyruar të veprojnë me kalime në llogari bankare.

Neni 36/2

Afishimi i çmimeve të shitjes

Tatimpaguesit, që kryejnë furnizime mallrash ose shërbimesh, janë të detyruar të afishojnë çmimin e shitjes së mallit që ata furnizojnë, ose shërbimit që ata kryejnë, pavarësisht nga natyra e furnizimit dhe nga statusi i blerësit. Në rastin e shitjeve me shumicë, afishimi nënkupton pasqyrimin e shitjes në një listë të veçantë, e cila hartohet nga tatimpaguesi.

Neni 36/3

Shmangiet tatimore

Shmangie tatimore quhet çdo veprim i tatimpaguesit, i cili paraqet pamje të rreme të të dhënave të tij identifikuese, vertetuar me fakte te argumentuara nga organi tatimor, me qëllim shtrembërimin e të dhënave të domsdoshme për vlerësimin dhe përcaktimin e detyrimeve tatimore.

Neni 36/4**

Dispozitat e këtij ligji dhe të gjitha dispozitat e ligjeve të tjera tatimore zbatohen edhe në rastin e ushtrimit të veprimtarive ekonomike, që bien në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, por që nuk përbëjnë vepër penale.

Neni 36/5*

Të gjithë tatimpaguesit, të cilët në veprimtarinë e tyre kryejnë njëkohësisht tregëti me shumicë për tatimpagues të tjerë dhe tregëti me pakicë për publikun e gjërë, janë të detyruar të bëjnë një gjë të tillë në vendë të veçanta, të ndara nga njeri tjetri. Në një mjedis të deklaruar si vend për shitje me shumicë për tatimpagues të tjerë nuk mund të bëhen shitje me pakicë për publikun dhe e kundërta, në një mjedis të deklaruar si vend për shitje me pakice per publikun nuk mund te behen shitje me shumice per tatimpagues të tjerë. Kur pretendohet se në mjediset e shitjes me pakice janë kryer edhe shitje me shumicë, këto të fundit vlerësohen sikur të jenë shitur me çmimet e shitjes me pakicë.

Neni 37

Pagimi i tatimeve

Tatimet janë të detyrueshme për t'u paguar në afatet e përcaktuara në ligjet e veçanta tatimore.

Neni 38

Vendi i pagimit të detyrimeve tatimore

1. Detyrimet tatimore paguhen në degët apo agjensitë bankare dhe në zyrat postare, organet eprorë të të cilave kanë marrëveshje kontraktuale me organet tatimore. Pagesat me valutë të huaj konvertohen në bankë me kursin zyrtar të këmbimit të ditës përkatëse.
2. Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve mund të hyjë në marrëveshje kontraktuale me subjekte, sipas të cilave ato marrin përsipër të pranojnë deklaratat tatimore dhe pagesat si një agjent tatimor. Subjektet që hyjnë në këto marrëveshje janë të detyruara të dërgojnë deklaratat dhe dokumentat shoqëruese në degët përkatëse të Drejtorisë së Përgjithshme. Pagesat tatimore depozitohen ose transferohen në llogarinë ose llogaritë e buxhetit të shtetit.
3. Kur degët dhe zyrat doganore mbledhin detyrime tatimore, shuma e derdhur në llogaritë përkatëse të doganave, në fund të asaj dite, do të transferohet e plotë në llogarinë bankare të organit tatimor përkatës.

Neni 39*

Kthimi i tatimeve të paguara më tepër dhe rimbursimi i TVSH-së

1. Kur tatimpaguesi pretendon se shuma e paguar e një tatimi është më e madhe se shuma e vlerësuar si e pagueshme, ai mund të kërkojë kthimin e saj. Administrata tatimore është e detyruar që të vendosë për kthimin ose jo të shumës së pretenduar si të paguar me tepër, duke e njoftuar me shkrim dhe në mënyrë të argumentuar tatimpaguesin brenda 60 ditësh nga data që ai ka paraqitur kërkesën me shkrim. Në çdo rast kthimi i shumës së paguar me tepër bëhet brenda 60 ditësh nga data e paraqitjes së kërkesës nga tatimpaguesi.

2. Në përputhje me ligjin “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” dhe nenet e tij lidhur me rimbursimin, tatimpaguesi rimbursohet sipas kohës dhe procedurave të përcaktuara në ligjin ligjin “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”.

3. Kthimi i shumave të paguara më tepër ose rimbursimi i TVSH mund të bëhet në një nga format e mëposhtme:

- a. duke e kaluar shumën e paguar më tepër për llogari të pagimit të detyrimeve të tjera tatimore të papaguara të tatimpaguesit.
- b. duke e kaluar shumën e paguar më tepër, me pelqimin e tatimpaguesit për llogari të pagimit të detyrimeve tatimore të mëvonëshme të tatimpaguesit.
- c. duke e kaluar shumën e paguar më tepër në llogarinë e tatimpaguesit.

4. Nëse shuma e paguar më tepër ose shuma e rimbursueshme nuk kthehet në një nga format e përcaktuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të pikës 3 të këtij neni, brenda afatit të caktuar nga data e paraqitjes së kërkesës, e cila nuk është refuzuar ose është pranuar sipas pikës 1 të këtij neni, administrata tatimore detyrohet të paguaj interesat e përcaktuara në nenin 44 të këtij ligji.

Neni 40

Zgjatja e afatit të pagesës

1. Përkundrejt një kërkesë me shkrim të argumentuar të tatimpaguesit, në përputhje me Rregulloren e Ministrit të Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve mund shtyjë afatin e caktuar për deklarimin dhe pagesën e një detyrimi, përveç TVSH-së, data e deklarimit dhe e pagesës të së cilës është absolute. Zgjatja nuk mund t'i kalojë 30 ditët dhe mund të bëhet vetëm kur ka arsye të forta dhe të argumentuara të cilat përcaktohen në Rregulloren e Ministrit të Financave. Zgjatja e afatit nuk ndërpret llogaritjen dhe pagimin e interesave. Ato llogariten dhe paguhen duke marrë për bazë datën normale të deklarimit dhe të pagesës së detyrimeve. Në rastet kur tatimpaguesi kërkon një zgjatje të afatit për të paguar detyrimin tatimor, organet tatimore mund të kërkojnë garanci. Zgjatja e afatit është një akt me shkrim.

2. Kërkesa për një garanci përfshin një përshtkrim të arsyeve për të dhe për shumën e kërkuar. Garancia jepet me para në dorë, depozita në llogari apo në tituj të shkëmbyeshëm, bono, dhe garanci bankare. Kërkesa për garanci i bëhet e ditur tatimpaguesit zyrtarisht. Ajo mund të apelohe në rrugë normale. Apelimi nuk përjashton tatimpaguesin nga paraqitja e garancisë.

Neni 41

Pagesa me këste

Në raste të veçanta dhe të argumentuara me gjëndjen financiare, kur një tatimpagues nuk mund të paguajë plotësisht dhe menjëherë detyrimin tatimor, organi tatimor përkatës, sipas kërkesës me shkrim të tij, mund të hartojë një plan pagese me këste. Në raste të tilla, kryetari i degës së tatimeve në rreth duhet të kërkojë garanci siç përmendet në pikën 2 të nenit 40 dhe tatimpaguesi duhet të paguajë interesat për të gjithë kohëzgjatjen e pagesës me këste. Ky favor anulohet kur kushtet në të cilat është hartuar, nuk ekzistojnë më. Plani i pagesës me këste është një marrëveshje me shkrim e përgatitur sipas përcaktimit në Kodin Civil dhe e firmosur nga Kryetari i Degës përkatëse të tatimeve e nga tatimpaguesi.

Neni 42

Radha e pagesës së detyrimeve tatimore.

Pagesa e detyrimeve tatimore nëBuxhetin e Shtetit bëhet sipas radhës së më poshtme:

- a) detyrimi tatimor
- b) interesat
- c) dënimet administrative.

Neni 43

Detyrimi për pagesë të menjëhershme

Para se të paraqiten për apelim, tatimpaguesit janë të detyruar të parapaguanjë vetëm detyrimin tatimor, pa përfshirë interesat dhe gjobat e mundshme ose të paraqesin garancitë e nevojshme. Në rastin e garancisë, për periudhën e apelimit, llogariten të gjitha interesat.

Neni 44*

Interesat për pagesë të vonuar

1. Nëse një tatimpagues nuk paguan ndonjë detyrim tatimor, brenda afatit të përcaktuar në legjislacionin tatimor, ai është i detyruar të paguaj interesa për pagesë të vonuar mbi shumën e papaguar, nga data e afatit deri në datën kur bëhet pagesa. Përfshihen nga pagimi i interesave për pagesë të vonuar tatimpaguesit, që i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar mbi fitimin sipas Ligjit "Për tatimin mbi të ardhurat".
2. Masa e interesit për pagesë të vonuar është 2 për qind për muajin e parë të vonesës, ose pjesë të tij dhe 1për qind në muaj për çdo muaj ose pjesë të tij që vijon.
3. Interesat për pagesë të vonuar vlerësohen dhe mblidhen në të njëjtën mënyrë si dhe detyrimet e tjera tatimore.
4. Interesat për pagesë të vonuar janë të pagueshme automatikisht dhe nuk mund të falen ose zvogëlohen nga asnjë autoritet.

Neni 45

Procedurat e zakonshme të mbledhjes me forcë të detyrimeve

1. Nëse një tatimpagues nuk ka paguar çfarëdo shume të detyrimit tatimor, administrata tatimore, nëpërmjet një urdhëri me shkrim i kërkon çdo banke që mban llogari të tatimpaguesit, t'i mbajë këtij të fundit një shumë, që është më e vogla ndërmjet:

a. shumës që, në përputhje me njoftimin, është kërkuar për t'u mbajtur;

b. shumës që, në atë kohë, disponon llogaria bankare e tatimpaguesit.

Shuma që administrata tatimore kërkon të mbahet nga çdo bankë nëpërmjet urdhërit me shkrim, është e para në radhën e pagesave, kur nuk përcaktohet ndryshe me një ligj tjetër.

1.1. Pika 1 e këtij neni nuk zbatohet kur :

a). Tatimpaguesi paguan detyrimin tatimor pa përfshirë gjokat dhe interesat dhe njëkohësisht e apelon atë në organet kompetente.

b). Tatimpaguesi vendos garancinë e kërkuar në nenin 43 dhe njëkohësisht apelon detyrimin në organet përkatëse.

2. Kur banka nuk mban shumën e kërkuar sipas pikës 1 të këtij neni, atëherë ajo i paguan organit tatimor një penaltet në masën 0,2 për qind në ditë për shumën e detyrimit të pambajtur.

3. Një kopje e çdo njoftimi të bërë sipas paragrafit 1 të këtij neni, do t'i jepet edhe tatimpaguesit.

Neni 46

Procedurat e jashtëzakonshme të mbledhjes me forcë të detyrimeve

Për tatimpaguesit të cilët nuk paguajnë detyrimet e tyre tatimore edhe pas marrjes së masave të zakonshme të nxjerrjes së detyrimeve tatimore, të përcaktuara në nenin 45 të këtij ligji, organet tatimore fillojnë marrjen e masave të jashtëzakonshme, si me poshtë:

a) mbylljen e veprimtarisë ekonomike të tatimpaguesit deri sa ky i fundit të ketë shlyer detyrimin e papaguar, por pa kaluar me shume 30 dite kalendarike nga çasti i mbylljes. Për këtë, kryetari i degës së tatimeve nxjerr një vendim të veçantë ekzekutiv, i cili ekzekutohet nga Policia Tatimore;

b) sekuestrimi i pasurisë, në rastet kur tatimpaguesi vazhdon të mos paguajë detyrimin tatimor edhe pse kanë kaluar më shumë se 30 nga çasti i mbylljes së veprimtarisë. Në këtë rast, kryetari i degës së tatimeve nxjerr një vendim të veçantë ekzekutiv, i cili ekzekutohet nga Policia Tatimore. Vendimi i veçantë ekzekutiv nuk kufizohet vetëm në shumën e tatimeve, por nuk duhet as të tejkalojë masën për sigurimin e pagesës së detyrimeve tatimore. Sekuestrimi i pasurisë ndjek këtë rradhë:

i) pasuritë e luajtshme;

ii) pasuritë e paluajtshme.

Pasuritë e sekuestruara si më sipër u nenshtrohen dispozitave të ligjit nr.7697, date 07.04.1993 "Per kundravajtjet administrative", i ndryshuar;

c) nëse dispozitat e mësipërme nuk mjaftojnë për mbledhjen e detyrimeve tatimore, kryetari i degës së tatimeve merr masat e mëposhtme:

i) bën denoncim në organet e Prokurorisë në bazë të nenit 181 të Kodit Penal;

ii) kërkon nga organet përkatëse të bllokojnë transferimin e pasurive të tatimpaguesit;

ç. në të gjitha rastet organi tatimor mund të kërkojë fillimin e procedurave të falimentimit si kreditor i interesuar, në mbështetje të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”.

Neni 46/1

E drejta e hyrjes dhe e inspektimit

Personi i autorizuar nga organi tatimor mund të hyjë dhe të kërkojë në çdo vend që përfshin çdo tokë, ndërtesë, automjet, anije etj., kur ai ka arsye për të besuar që mallrat ose dokumentat e përdorura prej personit të tatueshëm për qëllimet e zbatimit të këtij ligji mbahen atje.

Personi i autorizuar nga organi tatimor, që hyn në mjediset e biznesit të tatimpaguesit, i inspekton ato duke kërkuar çdo dokument, gjendjen e mallrave etj. Ai mund të inspektojë dhe të marrë kopje të çdo llogarie, regjistrimi ose dokumenti. Ai mund të inspektojë dhe të kontrollojë, gjithashtu, edhe operimet me kompjuter, arka regjitruese ose pajisje të tjera, si dhe të marrë kopje të çdo llogarie, regjistrimi ose informacioni tjetër të mbajtur nëpërmjet këtyre mjeteve.

Neni 46/2

Parashkrimi i detyrimeve të papaguara

1. Afati i parashkrimit të një detyrimi tatimor të papaguar është 6 vjet nga data kur vlerësimi tatimor i është njoftuar zyrtarisht tatimpaguesit. Afati i parashkrimit ndërpritet në rastet e mëposhtme:

- a. gjatë apelimit të këtij detyrimi;
- b. gjatë kohëzgjatjes së garancisë për këtë pagesë tatimore;
- c. gjatë periudhës në të cilën tatimpaguesi është nën një hetim zyrtar në një çështje penale që ka lidhje me këtë detyrim, deri në dhënien e një vendimi përfundimtar;
- ç. gjatë periudhës në të cilën tatimpaguesi është përfshirë në një çështje penale që ka lidhje me këtë detyrim tatimor.

2. Pas çdo ndërprerje, afati rifillon nga çasti i ndërprerjes. Në çdo rast, e drejta për të mbledhur një detyrim tatimor të papaguar, parashkruhet 15 vjet nga data kur vlerësimi tatimor i është njoftuar zyrtarisht tatimpaguesit.

Neni 47

Përcaktimi dhe pagimi i gjobave për dënimet administrative.

Në rastet e shkeljeve të legjislacionit tatimor, dënimet përcaktohen në vartësi të shkeljes, për rastet konkrete, dhe në bazë të dhënave të mëparshme për tatimpaguesin. Organet tatimore përcaktojnë dënimet administrative në të njëjtën kohë që përcaktojnë dhe shkeljen përkatëse për të cilën ato vihen. Për çdo qëllim, gjobat vlerësohen si një pjesë e pandarë e detyrimit tatimor të tatimpaguesit. Të gjitha procedurat dhe apelimet që zbatohen për tatimet përdoren edhe për gjobat. Gjobat janë si çdo detyrim tjetër tatimor dhe paguhen në të njëjtën mënyrë si dhe tatimet. Kur bëhet më shumë se një shkelje, vendosen dënime administrative të veçanta për secilën prej tyre.

Neni 48

Shkeljet dhe dënimet e përcaktuara në ligjet e veçanta tatimore

Për shkeljet e përcaktuara në ligjet e veçanta tatimore, jepen dënime administrative në përputhje me përcaktimin e bërë në këto ligje.

Neni 49

Shkeljet dhe dënimet në lidhje me regjistrim

1. Jane shkelje dhe denohen me gjobe rastet e mëposhtëme:

a) kryerja e veprimtarisë pa u pajisur më parë me çertifikatën tatimore, e cila denohet si me poshte:

i) mbyllja e veprimtarisë për 15 dite kalendarike;

ii) gjobë 75 mijë lekë, për tatimpaguesit e regjistruar në TVSH, të cilëve u ka kaluar afati i regjistrimit;

iii) gjobë 35 mijë lekë, për tatimpaguesit e taksës vendore mbi biznesin e vogël, të cilëve u ka kaluar afati i përcaktuar në shkronjën “a”;

b) mosnjoftimi i organeve tatimore për ndryshime në të dhënat e tatimpaguesit, si mosnjoftimi për ndryshimin e adresës së veprimtarisë dhe mosnjoftimi i adresave të reja të ushtrimit të veprimtarisë, denohen me gjobë 35 mijë lekë.

2. Kur edhe pas vendosjes së dënimeve të mësipërme, tatimpaguesi vazhdon të mosregjistrohet, kryetari i degës së tatimeve të rrethit përkatës ka të drejtë të nxjerrë një vendim të veçantë ekzekutiv, me anë të të cilit urdhëron:

a) vendosjen e sekuestros mbi mallrat, materialet, të ardhurat e realizuara dhe mbi aktivet e tjera, të përdorura për veprimtarinë ekonomike;

në rastet kur edhe pas marrjes së të gjitha masave të mësipërme tatimpaguesi nuk regjistrohet, ose në rastet e kundërshtimit me dhunë prej tij, drejtpërdrejt ose terthorazi, vetë ose nëpërmjet personave të tjerë, bëhet kallzim penal, në përputhje me dispozitat e Kodit Penal.

Neni 50

Shkeljet dhe dënimet për agjentët tatimorë

1. Përbëjnë shkelje për agjentët tatimorë:

a. Mosllogaritja, mosmbajtja e tatimeve në burim dhe e taksave për tatimpaguesin dhe mostransferimi në buxhet, në mënyrë korrekte dhe në kohën e duhur i tatimeve dhe taksave.

b. Mosmbajtja e regjistrimeve për të ardhurat e paguara tatimpaguesve dhe për tatimet e taksat e mbajtura dhe të transferuara në buxhet duke përfshirë mbajtjen e regjistrimeve të veçanta për çdo tatimpagues.

c. Mosdhënia organeve tatimore e dokumentacionit të kërkuar për kontrollin e saktësisë së llogaritjeve, të mbajtjes në burim dhe të pagimit të tatimeve e taksave.

2. Për shkeljet e përcaktuara sipas pikës 1 të këtij neni, jepen këto dënime:

a. Për shkeljet e përcaktuara në pikën 1 shkronja “a”, agjentët tatimorë janë të detyruar të paguajnë përveç detyrimit tatimor edhe një gjobë të barabartë me shumën e këtij detyrimi.

b. Për shkeljet e përcaktuara në pikën 1 shkronja “b”, agjentët tatimorë denohen me gjobë në masën 10 mijë deri në 50 mijë lekë.

c. Për shkeljet e përcaktuara në pikën 1 shkronja “c”, agjentët tatimorë denohen me gjobë në masën 50 mijë lekë.

Neni 50/1

Shkeljet dhe dënimet për klientët

Kushdo që blen mallra e shërbime është i detyruar të kërkojë të pajiset me dokumentin e blerjes, që mund të jetë fature TVSH-je, faturë e thjeshtë ose kupon tatimor (i lëshuar me arkë regjistruese). Mospajisja e këtyre dokumenteve:

1. Nga ana e blerësve individë, dënohet me gjobë me vlerën 5.000 lekë.
2. Nga ana e blerësve që janë tatimpagues të taksës vendore për biznesin e vogël, dënohet me gjobë me vlerën 20 mijë lekë.
3. Nga ana e blerësve që janë tatimpagues të regjistruar në TVSH-në, si dhe në çdo rast tjetër, dënohet me gjobë me vlerë 30 mijë lekë.

Neni 51

Shkeljet dhe dënimet për mosdhënie informacioni

Për këdo që nuk jep për organet tatimore informacionet e përcaktuara sipas neneve 65, 66 dhe 67 të këtij ligji, jepet një dënim 100 mijë deri në 200 mijë lekë.

Neni 52

Shkeljet dhe dënimet për mosdokumentim

Ruajtja, përdorimi dhe transportimi i mallrave pa dokumentacionin e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave, në zbatim të këtij ligji, kur nuk është përcaktuar ndryshe në këtë ligj dhe në ligjet e veçanta tatimore, dënohet me gjobë 40 mijë lekë. Në rastin e transportit të mallrave, përveç gjobës së mësipërme, transportuesit i bllokohet edhe leja e qarkullimit të mjetit, derisa ai të paguajë gjobën.

Neni 52/1

Shkeljet dhe dënimet për kryerjen e arkëtimeve dhe të pagesave me lekë në dorë (cash)

Kryerja me lekë në dorë e transaksioneve të shitblerjes, që kalon shumën 500 mijë lekë për vitin 2004 dhe 300 mijë lekë për vitet në vijim, duke përjashtuar personat fizikë jotregëtarë, përbën shkelje si për shitësin edhe për blerësin dhe secili prej tyre dënohet me një gjobë të barabartë me 5 përqind të vlerës së transaksionit të kryer.

Neni 52/2

Shkeljet dhe dënimet për mosafishimin e çmimeve të shitjes

Mosafishimi i çmimeve të shitjes së mallrave ose i shërbimeve përbën shkelje dhe dënohet me gjobë 50 mijë lekë për tatimpaguesit e regjistruar në TVSH dhe me gjobë 10 mijë lekë për tatimpaguesit e taksës vendore për biznesin e vogël.

Neni 52/3

Shkeljet dhe dënimet për mosregjistrimin ose mosdeklarimin e punonjësve për sigurimet shoqërore e shëndetësore.

1. Mosdeklarimi i çdo punonjësi në administratën tatimore konsiderohet shkelje dhe përveç detyrimit për pagimin e shumës së kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore të papaguara apo të Tatimeve të papaguara, dënohet

edhe me 10.000 (dhjetëmijë) lekë gjobë për çdo punonjës të padeklaruar. Në këtë rast, gjoba për çdo punonjës të padeklaruar vendoset në vend nga punonjësi i Policisë Tatimore apo nga çdo punonjës tjetër i administratës tatimore, i autorizuar për këtë qëllim.

2. Vlerësimi i shumës së kontributeve apo i shumës së Tatimeve, që duhet të paguajë tatimpaguesi, sipas pikës 1 të këtij neni, bëhet nga punonjësit e vlerësimit, në bazë të të dhënave të punonjësve të Policisë tatimore apo të çdo punonjësi tjetër të administratës tatimore, të autorizuar me shkrim për kontrollin e numrit të punonjësve.

Neni 53***

Shkeljet dhe dënimet për moslejimin e hyrjes dhe të kontrollit

1. Moslejimi nga tatimpaguesit i hyrjes dhe pengimi për kryerjen e kontrollit nga ana e organeve tatimore apo përpjekjet e tatimpaguesve për të ndaluar veprimin e organeve tatimore direkt apo indirekt, vetë ose nëpërmjet një personi tjetër, konsiderohen shkelje të këtij ligji dhe dënohen:

- a) Tatimpaguesit e regjistruar për TVSH-në dënohen me gjobë 1 milion lekë.
- b) Tatimpaguesit e regjistruar për taksën vendore për biznesin e vogël dënohen me gjobë 10 mijë deri në 20 mijë lekë.

***2) Në çdo rast, të drejtën e dënimit me gjobë, sipas pikës 1 të këtij neni, e ka kryetari i degës së Tatimeve.

Neni 54

Shkeljet dhe dënimet penale

Shkeljet që përbëjnë vepër penale, përveç dënimeve administrative të përcaktuara në këtë ligj dhe në ligje të tjera tatimore, dënohen edhe penalisht, në përputhje me dispozitat e Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 55***

Procedurat e apelimit

1. Çdo tatimpagues ka të drejtë të apelojë kundrejt:
 - a) çdo vlerësimi që vendos një detyrim tatimor, interes ose gjoba për tatimpaguesin;
 - b) çdo vendimi të organit tatimor për pretendimin e tatimpaguesit për rimbursim ose perjashtim tatimor;
 - c) çdo akti zyrtar të organit tatimor për mënyrën e përcaktimit të detyrimit tatimor, për bazën ligjore të përcaktimit si dhe ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të organit tatimor.
 - ç) çdo vendimi ekzekutiv të posaçëm tatimor në lidhje me tatimpaguesin.
2. Apeli duhet të bëhet me shkrim dhe në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të ligjit.
3. Tatimpaguesi duhet të paraqesë apelimin në shkallën më të ulët të sistemit të apelimit brenda 30 ditësh nga marrja e vlerësimit ose e njoftimeve të tjera zyrtare, me të cilin lidhet apelimi.

***Për qëllime të këtij ligji ose të ligjeve të tjera tatimore, datë e marrjes së njoftimit të vlerësimit apo të njoftimeve të tjera zyrtare, vlerësohet data e dhjetë pas dorëzimit të njoftimit në shërbimin postar. Përgjegjësia për mosmarrjen në kohë të njoftimit të dorëzuar në shërbimin postar është e tatimpaguesit, i cili është i detyruar të deklarojë adresën e saktë, që të sigurojë marrjen në kohë të njoftimeve nga shërbimi postar.

Administrata tatimore mund ta dërgojë njoftimin e vlerësimit ose njoftimet e tjera zyrtare dorazi. Në këtë rast, datë e marrjes së njoftimit vlerësohet data, kur njoftimi i jepet në dorë tatimpaguesit dhe konfirmohet nga ky i fundit. Në rast refuzimi nga tatimpaguesi, njoftimi vlerësohet i marrë datën e refuzimit

4. Hierarkia e organeve të apelimit për tatimet, nga shkalla më e ulët në atë më të lartë, është si më poshtë:
 - a) kryetari i komunës ose bashkisë, për taksat dhe tarifatat vendore;
 - b) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për tatimet dhe taksat kombëtare, si dhe për detyrimet e tjera të administruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
 - c) Komisioni i Apelit të Tatimeve për të gjitha llojet e detyrimeve të administruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
 - ç) Gjykatat.
5. Një apelim nuk mund të shqyrtohet në një shkallë më të lartë të hierarkisë së apelimit pa qenë shqyrtuar më parë nga shkalla më e ulët pararendëse, përveç rastit të parashikuar në nenin 57 të Ligjit.

Neni 56***

Procedurat e shqyrtimit të apelimeve tatimore

Gjatë shqyrtimit të apelimit tatimor, organi tatimor ka të njëjtën të drejtë, si edhe organi që përcakton detyrimin tatimor fillestar. Ky organ nuk kufizohet vetëm në çështjet e ngritura në apelim, ai mund të njihet me të gjitha problemet tatimore. Tatimpaguesi ka të drejtë të paraqitet vetë për të shpjeguar çështjet e apelimeve tatimore. Apeli tatimor nuk mund të tërhiqet nëse zbulohen fakte që vërtetojnë se shumica e detyrimeve të caktuara nuk është e mjaftueshme.

Në çdo rast tjetër, tatimpaguesi ka të drejtë në çdo kohë të tërheqë apelimin tatimor.

***Në rastin e një apelimi tatimor, organi që ka të drejtën e shqyrtimit të apelimit ka, gjithashtu, të drejtën të heqë tërësisht apo pjesërisht dënimet, pavarësisht nga fakti nëse detyrimi për tatimin qëndron ose jo.

Neni 57***

Apelimi në degët e tatimeve dhe në Drejtorinë e Përgjithshme

Për shqyrtimin e apelimeve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, krijohet Drejtoria e Apeliteve Tatimore, si pjesë përbërëse e strukturës organizative të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Drejtori i Drejtorisë së Apeliteve Tatimore emërohet nga Ministri i Financave. Drejtoria e Apeliteve Tatimore ka autoritetin e nevojshëm për të shqyrtuar apelimet që kanë të bëjnë me vlerësimet tatimore, të paraqitura nga tatimpaguesit, përfshirë edhe të drejtën

për të kryer hetime, kontrole dhe rillogaritje të detyrimeve tatimore. Në bazë të shqyrtimit të apelimeve, ajo merr vendimin përkatës. Drejtoria e Apelimeve Tatimore është e pavarur në vendimmarrje. Vendimi i kësaj Drejtorie duhet të jetë i argumentuar dhe të merret jo më vonë se 30 ditë nga data, kur është paraqitur kërkesa për apelim nga tatimpaguesi. Mosmarrja e vendimit për rezultatin e apelimit brenda afatit dhe mosdërgimi i tij tek tatimpaguesi, i jep të drejtën tatimpaguesit për t'u ankuar në shkallën tjetër më të lartë të apelimit, pa paraqitur rezultatin e shqyrtimit të shkallës më të ulët të apelimit.

Neni 58

Komisioni i apelimit të tatimeve

Komisioni i Apelimit vendos mbi bazën e të gjithë të dhënave të dhëna që ka, pa u kufizuar në propozimet e palëve apo në detyrimin tatimor të përcaktuar më parë. Kur Komisioni i Apelimit Tatimor shqyrton një apelim dhe Dega është e mendimit se detyrimi tatimor i përcaktuar duhet të ndryshohet, të dyja palët thirren shprehimisht të paraqiten përpara Komisionit. Vendimi duhet të jetë i arsyetuar dhe i dërgohet tatimpaguesit, jo më vonë se 30 ditë nga data në të cilën është paraqitur kërkesa për apelim.

Neni 59

Sistemi gjyqësor

Tatimpaguesi, pasi ka ndjekur të gjitha shkallët e ankimit administrativ të parashikuar në këtë ligj, ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës.

Neni 60

E drejta për informim e tatimpaguesve

Kur ndaj një tatimpaguesi hapet një çështje gjyqësore, ai ka të drejtë të shqyrtojë dokumentacionin përkatës, përveç rasteve kur është e rëndësishme ruajtja e sekretit të interesave publike apo private, siç është rasti i sekretit të biznesit të një të treti si dhe rasti i sekretit të identitetit të informatorëve. Mospranimi i kërkesës për ekzaminim kërkon një vendim të veçantë ekzekutiv nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve.

K R E U I V

KONTROLI ADMINISTRATIV

Neni 61

Mbajtja e regjistrimeve

1. Tatimpaguesit të cilët janë subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar janë të detyruar të mbajnë regjistra, libra, dokumentacion dhe llogari kontabile në përputhje me ligjin "Për Kontabilitetin", me ligjin "Për dokumentimin dhe mbajtjen e llogarive për

tatimet”, me ligjin “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar” dhe me aktet nënligjore në zbatim të tyre.

2. Tatimpaguesit të cilët janë subjekte të taksës vendore për biznesin e vogël janë të detyruar të mbajnë rregjistra, libra dhe dokumentacion në përputhje me ligjin “Për dokumentimin dhe mbajtjen e llogarive për tatimet”, me ligjin “Për taksën vendore për biznesin e vogël” dhe me aktet nënligjore në zbatim të tyre.

3. Tatimpaguesit e tjerë janë të detyruar të mbajnë regjistrimet dhe dokumentacionin e nevojshëm për përcaktimin e detyrimeve të tyre tatimore.

Neni 62*

Paraqitja e të dhënave dhe deklarimi

1. Tatimpaguesit janë të detyruar të paraqesin deklarata tatimore periodike në afatet dhe mënyrat e përcaktuara në ligjet e veçanta tatimore.

2. Organet tatimore u shpërndajnë tatimpaguesve, pa asnjë kusht formularët e deklaratave një herë në 6 muaj. Mënyra dhe koha e shpërndarjes së tyre përcaktohen me udhëzim të veçantë. Fakti që një tatimpagues ose përfaqesuesi i tij nuk i kanë marrë këto deklarata, nuk do të thotë që ai përjashtohet nga detyrimi i paraqitjes së deklaratës të plotësuar. Cilido që nuk e ka marrë këtë deklaratë duhet ta kërkojë atë në organin tatimor përkatës.

Neni 63

Kontrollet tatimore

1. Punonjësit e organeve tatimore kanë të drejtë të kontrollojnë kontabilitetin e tatimpaguesve, duke përfshirë edhe dokumentacionin mbi të ardhurat, fitimin, kapitalin dhe marrëdhëniet financiare me të tretët. Organet tatimore kanë gjithashtu të drejtë të kontrollojnë saktësinë e të gjithë dokumentave që kanë të bëjnë me veprimtarinë ekonomike, tatimet dhe kamatat përkatëse, me pagesën e detyrimit tatimor, dënimet administrative dhe interesat, deklaratat periodike si edhe dokumenta të tjera që kanë të bëjnë me përcaktimin e detyrimit tatimor. Për të ushtruar kontrole punonjësit organeve tatimore duhet të paraqesin identitetin e tyre.

2. Gjatë ushtrimit të një kontrolli organet tatimore kanë të drejtë të marrin kopje të çdo llogarie, regjistrimi apo dokumenti tjetër. Ato kanë të drejtë gjithashtu të kontrollojnë operimet e çdo kompjuteri, të arkave regjistruese apo të çdo pajisjeje tjetër dhe të marrin kopje të çdo llogarie, regjistrimi apo informacioni tjetër në këto pajisje.

3. Pas çdo kontrolli, punonjësit e organeve tatimore duhet të paraqesin një raport me shkrim, ku të përshkruhen në detaje rezultatet e kontrollit. Tatimpaguesi ka të drejtë të mbajë një kopje të këtij raporti, dhe të paraqesë observacionet e veta me shkrim.

Në bazë të rezultateve të kontrollit, organet tatimore përgatisin njoftimin e vlerësimit tatimor. Afati brenda të cilit njoftimi i vlerësimit tatimor përgatitet dhe i njoftohet tatimpaguesit është 15 ditë nga përfundimi i kontrollit. Kohëzgjatja e një kontrolli nuk mund të jetë më shumë se 30 ditë kalendarike. Në raste të veçanta, Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, me kërkesën e degës së tatimeve, mund ta zgjasë këtë afat.

Neni 64

Përdorimi i ekspertëve

Organet tatimore mund të të kërkojnë asistencë teknike nga ekspertë të fushave të tjera, me qëllim që të jenë në gjendje të vleresojnë detyrimin tatimor të tatimpaguesve. Informacioni konfidencial rreth tatimpaguesit nuk i jepet ekspertit.

Neni 64/1

Stimujt për kontrollet e organeve tatimore

Të ardhurat që burojnë nga zbulimet e kryera nga organet tatimore, por dhe që janë arkëtuar, shperndahen si vijon:

- a. 80 për qind për Buxhetin e Shtetit, në llogaritë përkatëse të të ardhurave tatimore;
- b. 20 për qind për organet tatimore, nga të cilat 5 për qind e tyre u jepet informatorëve për informacionet e dhëna, që çojnë në zbulimin e të ardhurave tatimore. Për çdo rast, informimi bëhet me shkrim. Nëse nuk ka pasur informatorë të tillë, ky 5 përqindësh i vihet në përdorim kryetarit të degës së tatimeve dhe përdoret sipas udhëzimeve të Ministrit të Financave.

Neni 65

Detyrimi i tatimpaguesve për të dhënë informacion

1. Tatimpaguesit janë të detyruar të bashkëpunojnë me organet tatimore, për të siguruar llogaritjen e saktë të detyrimeve tatimore. Në qoftëse organet tatimore kërkojnë, tatimpaguesit janë të detyruar të japin shpjegime me gojë apo me shkrim, të paraqesin librat e kontabilitetit, si dhe informacione të tjetra që shërbejnë për të sqaruar çdo rrethanë që ka të bëjë me detyrimet tatimore. Në mënyrë të veçantë, organet tatimore kanë të drejtë të kërkojnë dokumentacionin që ka të bëjë me marrëdhëniet financiare të tatimpaguesit me të tretët.

Për të lehtësuar këtë proces, tatimpaguesit janë të detyruar:

- a. Të plotësojnë, të firmosin dhe të kthejnë me postë pyetësorët, vërtetimet e kërkuara dhe të dhëna të tjera, 15 ditë brenda datës së marrjes së kërkesës.
- b. Të takohen me punonjësit e organeve tatimore për t'iu përgjigjur pyetjeve dhe për të dhënë informacionin e kërkuar.

2. Në qoftëse organeve tatimore u refuzohet dhënia e informacionit të nevojshëm për llogaritjen e detyrimeve tatimore, ato kanë të drejtë të bëjnë vleresim tatimor nga zyra duke i llogaritur detyrimet e tatimpaguesit mbi bazën e vleresimit të tyre dhe të të dhënave të siguruara nga jashtë. Në këtë situatë, barra e provës i takon tatimpaguesit pra është detyrë e tij të provojë të kundërtën.

Neni 66

Detyrimi i palëve për të dhënë vetë informacione, pa kërkesën e organeve tatimore

1. Personat fizikë dhe juridikë si edhe organizmat e ndryshëm qeveritarë janë të detyruar t'u japin organeve tatimore informacione të ndryshme për përcaktimin sa më të saktë të detyrimit tatimor, gjithnjë në përputhje me ligjet dhe aktet e tjera nënligjore. Ata janë gjithashtu të detyruar të lejojnë organet tatimore të shqyrtojnë të gjitha dokumentet tatimore dhe çdo dokument tjetër që shërben për llogaritjen e detyrimeve tatimore.

2. Detyrohen të dorëzojnë informacionet e kërkuara në formatin dhe në kohën e caktuar siç është përcaktuar me akte nënligjore, subjektet e mëposhtëme:

- a. Sistemi Gjyqësor;

i) Për rastet kur tatimpaguesit pushojnë aktivitetin, shpërndahen, ose pësojnë ndryshime thelbësore brenda kuptimit të ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”. Këto ndryshime duhet të vërtetohen me një vendim gjyqësor. Gjykatat duhet të njoftojnë organet tatimore për të gjitha ndryshimet në regjistrim, brenda 5 ditëve të bërjes së ndryshimeve. Në rastet kur bëhet fjalë për detyrimin tatimor, gjykatat nuk mund të nxjerrin një vendim përfundimtar derisa organet tatimore të vërtetojnë se janë paguar të gjitha detyrimet tatimore ose janë siguruar garancitë e duhura.

ii). Gjykata dërgon në organet tatimore kopje të vendimeve gjyqësore së bashku me kërkesën e tatimpaguesit.

b. Drejtoria Përgjithshme e Doganave dhe degët e saj janë të detyruara të shënojnë në fletën e zhdoganimit të importeve dhe në daljen e eksporteve numrin e identifikimit të tatimpaguesit sipas çertifikatës së TVSH-së, kodin fiskal të tij, vitin dhe vendin ku është regjistruar tatimpaguesi, si dhe çdo të dhënë tjetër që mund të kërkohej me rregullore të veçantë nga Ministri i Financave. Ato janë të detyruara të mos bëjnë veprime zhdoganimi e doganimi të mallrave kur tatimpaguesit nuk paraqesin çertifikatën e regjistrimit si tatimpagues dhe çertifikatën e TVSH-së. Në këto raste dega apo zyra doganore njofton organin tatimor të rrethit ku zhvillon veprimtarinë tatimpaguesi.

c. Zyrat e Regjistrimit të Pasurive janë të detyruara të japin listën e akteve të regjistrimit të pasurisë në rastet e kalimit të pronësisë nëpërmjet shitjes, dhurimit e trashëgimisë.

ç. Punëdhënësit si ata privatë dhe shtetërorë, informojnë organet tatimore për të gjithë të punësuarit dhe për të gjitha tatimet e mbajtura në burim për këto të punësuar.

Neni 66/1

Detyrimi i bankave për të dhënë informacion për numrin e llogarisë së subjekteve tatimpaguese pa kërkesën e organeve tatimore

Bankat dhe filialet e tyre në rrethe janë të detyruara të njoftojnë organet tatimore për llogaritë e hapura dhe për ato që do të hapen të tatimpaguesve. Njoftimi bëhet një herë në tri muaj për të gjitha llogaritë e hapura dhe të mbyllura gjatë tremujorit përkatës. Ai përmban emrin ose emrin tregtar të tatimpaguesit, numrin dhe datën e llogarisë se hapur, si dhe numrin dhe datën e llogarisë se mbyllur. Njoftimi i parë, që bankat bëjnë për organet tatimore, përfshin të gjithë periudhën e mëparshme, pavarësisht nga koha kur llogaria është hapur.

Neni 67

Detyrimi i palëve të treta për të dhënë informacione

Organet tatimore mund të kërkojnë informacione nga palët e treta me qëllim përcaktimin e detyrimit të çdo tatimpaguesi. Kërkesa bëhet me shkrim dhe dërgohet me postë. Janë të detyruar të kthejnë përgjigje falas me shkrim personat juridikë dhe individët e mëposhtëm:

a. Shoqëritë e Sigurimeve për pagesat që lidhen me dëmshpërblimet.

b. Shoqëritë tregëtare për:

i) Dividentët ose ndarjet e fitimit që u paguhen aksionerëve ose ortakëve;

- ii) Personat që kanë ose kanë pasur më parë marrëdhënie ekonomike me shoqërinë për çështjet që kanë lidhje me pretendimet, qiratë ose punësimin;
- iii) Marrëdhëniet me nënkontraktorët;
- iv) një listë vjetore të marrëdhënies me kreditorët;
- c. Bankat dhe institucionet financiare për:
 - i) të ardhurat që rrjedhin nga interesa e shpenzime për pagesat e interesave;
 - ii) Depozitat dhe detyrimet në fund të çdo viti;
 - iii) Transaksionet bankare.
- ç. Fondet e Investimeve për letrat me vlerë.
- d. Agjentët e pasurive të paluajtshme për listën e përvitshme të transaksioneve të plota sipas emrit të klientit.
- dh. Personat e përfshirë në blerjen dhe shitjen e mallrave për të gjitha transaksionet e kryera.
- g. Institucionet dhe personat juridikë, të huaj dhe vendas, për pagesat ndaj personave që nuk janë residentë në Republikën e Shqipërisë.
- h. Donatorët e ndryshëm për fondet e lëvruara tatimpaguesve, përkundrejt furnizimit të mallrave ose shërbimeve që ato kryejnë me këto fonde.

Neni 68

Ruajtja e sekretit

Punonjësit e organeve tatimore janë të detyruar të ruajnë sekretin sipas ligjeve në fuqi për të dhënat me të cilat njihen gjatë ushtrimit të detyres. Të dhënat e tatimpaguesve përdoren brenda organeve tatimore vetëm për nevojat e administrimit të tatimeve. Punonjësit e organeve tatimore nuk pranojnë kërkesat e paautorizuara për të shqyrtuar materiale brenda juridiksionit të tyre. Detyra e personelit të organeve tatimore për ruajtjen e sekretit vazhdon pavarësisht nga statusi i punësimit.

Organet tatimore mund të botojnë të dhëna të ndryshme për tatimpaguesit, në formën e një buletini periodik. Lloji i të dhenave që mund të botohen përcaktohet në marrëveshje me Dhomën e Tregëtisë dhe të Industrisë.

Neni 69

Informacioni i organeve shtetërore

Organet tatimore mund të japin informacione në lidhje me tatimpaguesit për organet e tjera shtetërore vetëm në rastet e mëposhtëme:

- a. Gjyqtarët dhe prokurorët të përfshirë në çështje tatimore në proces, si dhe në çështje të tjera penale, në përgjigje të kërkesës me shkrim për të ndihmuar me informacion në ndjekjen e çështjeve penale;
- b. Kontrollin e Lartë të Shtetit, për të gjithë tatimpaguesit që ka të drejtë ai t'i kontrollojë në bazë të ligjit;
- c. Gjykatat, në të gjitha rastet për tatimpaguesit të cilët nuk kanë ushtruar veprimtari ose nuk kanë paraqitur asnjë deklaratë për një periudhë prej më shumë se dy vjetësh. Në këto raste, organet tatimore kanë të drejtë, si palë të interesuara, të kërkojnë nga gjykata çregjistrimin e personit sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 70*

Konfirmimi i statusit të tatimpaguesit

Me kërkesën e tatimpaguesit, organet tatimore janë të detyruara të lëshojnë vërtetim për statusin tatimor të tatimpaguesit, jo më vonë se 3 ditë pune nga data e kërkesës.

K R E U V DISPOZITA TRANZITORE DHE TE FUNDIT

Neni 71

Rreziku i dyfishtë

Rezultati i një çështjeje civile nuk ka lidhje me të drejtën e organeve tatimore për të ngritur një çështje penale.

Neni 72

Efekti mbi detyrimet tatimore egzistuese

Çështjet në shqyrtim dhe përcaktimet e detyrimeve tatimore që nuk kanë përfunduar ende, nuk ndikohen nga hyrja në fuqi e këtij Ligji.

Neni 72/1***

Dispozitat e këtij ligji janë të detyrueshme për zbatim si për tatimpaguesit dhe për administratën tatimore, edhe për administrimin e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Neni 73

Organet e ngarkuara me zbatimin e këtij ligji

Me zbatimin e këtij ligji ngarkohet Ministria e Financave dhe organet tatimore sipas përcaktimit në nenin 15 të këtij ligji.

Neni 74

Akte nënligjore

Ministri i Financave nxjerr rregullore dhe udhëzime në bazë dhe për zbatimin e këtij ligji.

Neni 75

Shfuqizime

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr. 7681, datë 04.03.1993 “Për administrimin e tatimeve dhe taksave në Republikën e Shqipërisë” me ndryshimet përkatëse, të gjitha aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tyre si, dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 76

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Jozefina TOPALLI (ÇOBA)

***** Ndryshuar me ligjet:**

Ligjit nr 8710, datë 15.12.2000

Ligjit nr 8846, datë 11.12.2001

Ligjit nr 8968, datë 07.11.2002

Ligjit nr 8980, datë 12.12.2002

Ligjit nr 9160, datë 18.12.2003

Ligjit nr 9333, datë 06.12.2004

Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 103 datë 29 dhjetor 2004

*****Ligji Nr. 9460 datë 21.12.2005**

Botuar në Fletoren Zyrtare Nr.105 datë Janar 2006

***** Ligji Nr. 9585, datë 17.07.2006, Ligj Nr. 9596, datë 27.07.2006,**

Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 84 datë 09.08.2006